



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:232955
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06231696

C-IV-14-4891

Ankuesi

Sh A fshati K , Lipjan.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaqi, me 30 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 20 janar 2014, ankuesi parashtroj ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me numër te referencës 4299/2, të dt.16.05.2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për realizimin e të drejtës së pronësisë në baze të Aktgjykimit të formës së prerë C.nr.202/95, dt.13.09.1996. Me 21.11.2023, gjykata lëshoj për ankuesin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.4 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Në vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 21 nëntor 2023, Gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesi, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai/ajo nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga ankuesi me datë 27 nëntor 2023, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Manushe Karaqi, Gjyqtare